



Prishtinë, 09 korrik 2020

## KOMUNIKATË

Odat e Professionistëve Shëndetësor në bashkë-koordinim me Federatën e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës (FSSHK), si organizata që përfaqësojnë interesat profesionale dhe socio-ekonomike të profesionistëve shëndetësor të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e përbashkët të përfaqësuesve, të mbajtur me 09 korrik 2020, në nivel të kryetarëve, kanë shkëmbyer informata relevante për vlerësimin e situatës aktuale me qëllim që të mënjanohet gjendja e vështirë e profesionistëve shëndetësor, ku kryetari i Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës (FSSHK) ka raportuar për takimet që ka pasur me akterët tjerë shëndetësor në adresimin e kërkesave të përbashkëta.

Kryesuesit e OPSHve dhe FSSHKsë morrën vendim për krijimin e komitetit të përbashkët për analizimin e menaxhimit të situatës së krijuar nga pandemia. Rekomandimet e dala nga ky komitet së bashku me informatat e përditësuara do të dërgohen në Ministrinë e Shëndetësisë për veprimet dhe hapat e mëtutjeshëm të cilat duhet marrë në menaxhimin e situatës.

Komiteti do të jetë i përbërë nga profesionist të profileve të ndryshme shëndetësore, të emëruar si përfaqësues të OPSHve:

Anëtarët e komitetit

- Dr. Islam Krasniqi
- Dr. Izet Sadiku
- Xhemajl Dugolli
- Dr. Demush Bajraktari
- Dr. Ferit Koçani
- Arbnore Ibrahimaj- Gashi PT

Odat e Profesionistëve Shëndetësor do të përkrahin dhe do të ndihmojnë brenda autorizimeve të veta ligjore, çdo veprim sindikal nga FSSHK-ja, lidhur me procesin e ngritjes së pagave të të gjithë profesionistëve shëndetësor, kushtet dhe sigurinë në punë.

Gjatë takimit të kryesuesve të OPSHve, kërkesë e Odës së Infermierëve të Kosovës ishte edhe çështja e barasvlerësimit të kodeve për profesionistët infermierë me shkollimin bachelor dhe shkollë të mesme, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë në Ligjin për Paga në sektorin publik, kërkesë e cila u përkrah nga kryesuesit e Odave të Profesionistëve Shëndetësor si dhe kryetari i Federates së Sindikatave të Shëndetësisë.

Kryetarët e OPSHve dhe FSSHKsë u dakorduan që takimet të jenë të përjavshme, në mënyrë që raportimet dhe informatat të jenë më transparente për një vendimarrje më të shpejtë.